

VENDIM

Nr. 612, datë 7.7.2015

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2015, MIRATUAR PËR PRESIDENCËN

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe nenit 13, të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Presidencës, në buxhetin e miratuar për vitin 2015, t’i shtohet fondi prej 10 750 000 (dhjetë milionë e shtatëqind e pesëdhjetë mijë) lekësh, për shpenzime korrente.
 2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë, miratuar për vitin 2015.
 3. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Presidenca për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama